



UNMIK



IPVQ

**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA**

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E TREGTISË
DHE INDUSTRIË
MINISTRY OF TRADE AND
INDUSTRY
MINISTARSTVO ZA
TRGOVINU I INDUSTRIJU**

**MINISTRIA E PUNËS DHE
MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR
AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I
SOCIJALNE ZAŠTITE**

**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS
DHE TEKNOLOGJISË
MINISTRY OF EDUCATION,
SCIENCE & TECHNOLOGY
MINISTARSTVO ZA
OBRAZOVANJE, NAUKU I
TEHNOLOGIJU**

“Shih mundësitë dhe shfrytëzoj ato!”

**Strategjia kombëtare për arsim dhe aftësim në
ndërmarrësi**

The publication has been produced with the assistance of the European Union. The contents of the publication is the sole responsibility of the Government of Kosovo and can in no way be taken to reflect the views of the European Union

PARATHENIE

Si kandidat e mundshme për hyrje në Bashkimin Evropian, Kosova është duke e zhvilluar “Planin Zhvillimor të Kosovës” (2007 – 2013). Ndërmarrësia është një nga çështjet e rëndësishme, e përfshirë në këtë plan. Ne vitet e fundit kemi një fokusim të shtuar për rëndësinë e ndërmarrësisë dhe krijimin e shëndoshë të saj, në dy nivelet, si atë kombëtare ashtu edhe vendore. Shkathtësitë e reja, janë gjithashtu thelbësore, nëse dëshirojmë të kemi komunitete të qëndrueshme vendore në tërë vendin.

Për të zhvilluar ndërmarrësinë duhet të krijojmë një kulturë më të mirë dhe kreative, dhe për të arritur këtë duhet të përqendrohemi tek të rinjtë. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të fitojnë vetëbesimin dhe fuqinë e tyre kreative si dhe mundësinë, që të shohin dhe shfrytëzojnë resurset lokale si bazë për zhvillimin e biznesit dhe punësimit. Atyre duhet tu jepet mundësia që të shohin dhe provojnë kreativitetin dhe vetëbesimin personal si dhe mundësinë për bashkëpunim, të cilat janë shtyllë përforcuese e ndërmarrësisë si dhe bazë për të qenë konstruktiv dhe kreativ në shkollë, shtëpi, punë dhe lojë.

Qëllimi i Qeverisë është që një numri sa më i madh i fëmijëve, studentëve dhe të rriturve t’iu ofrohen njohuri praktike dhe teorike në ndërmarrësi. Deri më tani, vetëm disa nxënësve, studentëve dhe të rriturve u është ofruar arsim dhe aftësim në ndërmarrësi. Qëllimi ynë është që ta ndryshojmë këtë. Në pajtim me Strategjinë e Lisbonës, qëllimi ynë është të përmirësojmë politikën dhe realizimin e arsimit dhe aftësimin në ndërmarrësi, në përputhje me Kartën e BE për ndërmarrjet e vogla (Kapitulli 1 - Arsimi dhe Aftësimi në Ndërmarrësi dhe Kapitulli 4 - Disponimi i shkathtësive). Duke marr për bazë rekomandimet e fundit të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për kompetenca kyçe dhe Agjendës së Oslos për arsimin për ndërmarrësi, gjatë fazës së parë të implementimit (2007 – 2010), do të pilotojmë arsimin për ndërmarrësi në shkollat fillore (ISCED 1 dhe ISCED 2) dhe ato të mesme (ISCED 3). Do të zgjerojmë edhe më tepër arsimin për ndërmarrësi në arsimin e mesëm profesional dhe ofrojmë masa përkrahëse për zhvillimin e kompetencës profesionale në ndërmarrësi nëpërmjet lëndëve zgjedhore (ISCED 4 dhe ISCED 5). Në periudhën afatgjatë, synojmë të sigurojmë që çdo nxënës/student është i përfshirë në procesin e mësimin për ndërmarrësi, për të zhvilluar shprehinë në ndërmarrësi dhe mënyrën e të menduarit, duke përdorur qasjen e integruar ndër-kurrikulare dhe/ose lëndëve (zgjedhore) për zhvillimin e shkathtësive për ndërmarrësi. Për arritjen e synimit tonë, do të zhvillojmë materialet e standardizuara të mësimdhënies; planifikimi dhe zbatimi i trajnimit të mësimdhënësve dhe përkrahja e menaxhmentit të shkollës dhe bartësit vendor.

Si pjesë e planit të qeverisë për politika të reja gjithëpërfshirëse, ju prezantojmë strategjinë për arsimin dhe aftësimin në ndërmarrësi me një plan të integruar të zbatimit për periudhën prej 2007 deri më 2010.

Ministri i Arsimit,
Shkencës dhe Teknologjisë
Agim Veliu

Ministri i Punës
dhe Mirëqenies Sociale
Ibrahim Selmanaj

Ministri i Tregtisë
dhe Industrisë
Bujar Dugolli



Përmbajtja

| | | |
|-------|--|----|
| 1. | Hyrje | 1 |
| 2. | Ndërmarrësia në sistemin e arsimit dhe aftësimin | 2 |
| 3. | Akterët | 4 |
| 4. | Statusi i ndërmarrësisë në arsim | 5 |
| 4.1 | Arsimi fillor dhe i mesëm | 5 |
| 4.1.1 | Arsimi Fillor | 5 |
| 4.1.2 | Arsimi i mesëm i ulët | 5 |
| 4.1.3 | Arsimi i mesëm i lartë. Pasqyrë e ngjashme | 5 |
| 4.1.4 | Shkollat e AAP | 5 |
| 4.2 | Arsimi i lartë | 6 |
| 4.3 | Aftësimi i mësimdhënësve dhe trajnerëve | 6 |
| 4.4 | Arsimi joformal | 6 |
| 4.5 | Aftësimi për ofruesit e shërbimeve të biznesit | 7 |
| 4.6 | Aftësimet për ndërmarrjet ekzistuese | 7 |
| 4.7 | Arsimi në ndërmarrësi dhe perspektiva evropiane | 8 |
| 5. | Sfidat | 9 |
| 6. | Qëllimet dhe plani i zbatimit | 10 |
| 6.1. | Qëllimet për të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin Synimet per Arsimin dhe Trajtime per te gjitha Nivelet | 10 |
| 6.2 | Qëllimet për nivelet e arsimit fillor dhe të mesëm (Përgjegjësia MASHT) | 10 |
| 6.3 | Qëllimet për arsimin e lartë (Përgjegjësia UP dhe MASHT) | 10 |
| 6.4 | Qëllimet për aftësimin e mësimdhënësve dhe trajnerëve | 10 |
| 6.5 | Qëllimet për mësimin joformal | 10 |
| 6.6 | Plani i zbatimit | 12 |
| 7. | Masat dhe iniciativat | 16 |
| 7.1 | Masat dhe iniciativat që aplikohen në të gjitha nivelet e arsimit | 16 |
| 7.2 | Masat dhe iniciativat në arsimin fillor dhe të mesëm | 16 |
| 7.3 | Masat dhe iniciativat në arsimin e lartë | 16 |
| 7.4 | Masat dhe iniciativat në arsimin joformal | 16 |
| 8. | Vlerësimi dhe Vazhdimësia | 17 |
| 8.1 | Vazhdimësia | 17 |
| 8.2 | Financimi | 17 |
| 8.3 | Vlerësimi | 17 |
| | Aneksi | 18 |

Lista e shkurtesave

| | |
|---------------|---|
| AAP | Arsimi dhe Aftësimi Profesional |
| AAN | Arsimi dhe aftësimi në ndërmarrësi |
| AER | Agjensioni Evropian për Rindërtim |
| AKK | Autoriteti Kosovar i Kualifikimeve |
| BE | Bashkimi Evropian |
| KKK | Korniza Kombëtare e Kualifikimeve |
| KKSC | Korniza Kombëtare e Sigurimit të Cilësisë |
| KOSVET | Arsimi dhe aftësimi profesional në Kosovë |
| MASHT | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë |
| MPMS | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale |
| MTI | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë |
| NVM | Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme |
| OJQ | Organizata Jo-Qeveritare |
| OSHB | Ofruesit e shërbimeve të biznesit |
| QAP | Qendra për Aftësim Profesional |
| UP | Universiteti i Prishtinës |

1. Hyrje

Ky zhvillim do të zë vend në kuadër të kornizës së përgjithshme të Kartës Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla dhe Plani Zhvillimor të Kosovës.

Vizioni për Kosovën:

“Ne linjë me Kartën e BE për Ndërmarrje të Vogla, Kosova do të vazhdojë me zhvillimin e mëtejme të arsimit dhe aftësimin në ndërmarrësi për nxënësit, studentët dhe të rriturit si në mësimin formal ashtu edhe jo – formal dhe të sigurojë që institucionet për aftësim dhe ofruesit e shërbimeve të biznesit, do të ofrojnë shkathtësi dhe njohuri, të përshtatura me nevojat e ndërmarrjeve të vogla”

“Shih mundësitë dhe shfrytëzoj ato” zhvillohet në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë ,Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe bartësve tjerë të radhitur në anekse. Plani përfshin programin e plotë të arsimit dhe aftësimin prej shkollës fillore deri te mësimi joformal, përfshirë aftësimin e mësimdhënësve dhe trajnerëve. Zhvillimi i strategjisë është përkrahur dhe moderuar nga projekti KOSVET III, që financohet nga BE dhe menaxhohet nga AER.

2. Ndërmarrësia në sistemin e arsimit dhe aftësisimit

- Ekziston një njohje e përgjithshme se të gjitha ekonomitë përfitojnë nga të rinjtë e vendit, që i ekspozohen informatës rreth mënyrës në të cilën punon industria dhe ekonomia dhe kulturës së domosdoshme kreative në një shoqëri të ndërmarrësisë për të rritur mundësitë e punësimit. Përveç përfitimeve ekonomike që shkathtësitë për ndërmarrësi mund të sjellin, promovimi i tyre është një dobi shtesë për komunitetin.
- Arsimi dhe aftësimi në ndërmarrësi ka të bëjë me zhvillimin e shkathtësive dhe kualiteteve personale, ashtu që të gjitha grupmoshat fitojnë njohuri dhe të kuptuar për mënyrën se si punon ekonomia dhe reagon në forcat e tregut. Kjo përfshin qasjet për zhvillimin e kreativitetit, zgjidhjen e problemit, punën në ekip, ndërmarrjen e rreziqeve të llogaritura, shkathtësitë për komunikim, udhëheqësinë, marrjen e vendimit, menaxhimin e kohës, marrjen e përgjegjësisë dhe shkathtësi të tjera individuale, që mund të çojnë të perspektivat e përmirësuara të punësimit. Arsimi dhe aftësimi i ndërmarrësisë në Kosovë identifikon edhe rolin e ndërmarrësit në shoqëri dhe kërkesat e ndryshme të vetëpunësimit. Metodologjia për realizimin e pakos së tillë të arsimit dhe aftësisimit është “të nxënit duke punuar”.
- Ekziston nevoja që zhvillimi i arsimit dhe aftësisimit për ndërmarrësi të zgjerohet përtej kornizës shkollore për të marrë parasysh nevojën për mësimin gjatë gjithë jetës dhe të sigurojë shkathtësi shtesë personale si dhe të përkrah zhvillimin e fillimit të biznesit dhe iniciativat e inkubatorëve të biznesit. Ofrimi i përkrahjes për sektorin e NVM dhe zhvillimi i profesioneve të zejtarisë në veçanti për gratë në komunitetet rurale është thelbësore për zhvillim.
- Në mënyrë që të arrihen zhvillimet në arsimin dhe aftësimin për ndërmarrësi, do të jetë e nevojshme që zhvillohet në mënyrë domethënëse kapaciteti i të gjitha institucioneve të përfshira. Një pjesë e madhe e këtij zhvillimi do të bëhet përmes krijimit të kurseve të duhura të kombëtare për mësimdhënës dhe trajnerë, të përfshirë në arsim dhe aftësim së bashku me rritje e numrit të tyre.
- Zhvillimi i Kornizës Kombëtare për Sigurimin e Cilësisë (KKSC) do të jetë standard matës për zhvillimin e arsimit dhe aftësisimit në ndërmarrësi, që do të ofrojë certifikimin për të përmbushur kriteret e KKK dhe si rrjedhim edhe të AKK. Kjo do të kërkojë koherencë të mëtejme të shërbimit ekzistues dhe krijimi i qasjeve të reja për zhvillimin e programeve.

- Standardet për arsimin dhe aftësimin në ndërmarrësi janë zhvilluar dhe ndërlidhen me kriteret ndërkombëtare. Këto do të formojnë bazën e zhvillimit të arsimit dhe aftësimin për ndërmarrësi dhe do të ndërlidhen me nivelet e identifikuara në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, në mënyrë që sistemi mësimor i Kosovës të përmbushë kërkesat e ardhshme.

3. Akterët

MASHT, MPMS, MTI, Oda Ekonomike, Shoqata e Grave Afariste , Aleanca Kosovare e Bizneseve, Bashkimi i Sindikatave te Pavarura, komunat, donatorët kryesor, pronarët privat te organizatave për aftësim, Shërbimet Këshillëdhënëse të Biznesit dhe Shoqata e Arsimit për të Rritur.

Akterët publik dhe privat zakonisht kane synime te përbashkëta, por ekziston një ndërveprim i vogël në mes tyre. Për të arritur një fokus të përbashkët dhe afatgjatë në këtë fushë, aktorët e ndryshëm duhet të punojnë së bashku dhe koordinojnë përpjekjet e tyre.

4. Statusi i ndërmarrësisë në arsim

4.1 Arsimi fillor dhe i mesëm

4.1.1 Arsimi Fillor. Momentalisht është e vështirë të identifikohet gjendja e arsimit për ndërmarrësi. Ekzistojnë raste të veçuara të praktikës së mirë, por shumica e tyre paraqiten si pjesë e aktiviteteve jashtë-kurrikulare, prandaj ekziston nevoja të krijohet diçka më e qëndrueshme. ARP Prishtinë ka paraqitur 6 programe në 24 shkolla, në të cilat janë aftësuar 44 mësime të mësuara. Në sektorin e shkollës fillore dhe të mesëm të ulët, 490 të rinj janë certifikuar dhe 1108 nxënës të shkollës së mesme, gjithashtu, janë certifikuar.

Ne kornizën e kurrikulit të ri të përpiluar nga MASHT në 2001, ka qenë e paraparë që ndërmarrësia të përfshihet (në klasat 1-5) por nuk është implementuar.

4.1.2 Arsimi i mesëm i ulët. Kurrikuli i stërngarkuar po ripunohet dhe aty ku ekziston ndërmarrësia, shpesh është pjesë e një planprogrami tjetër. REA Prishtinë ka zhvilluar një Pilot skemë në 24 shkolla ku 44 mësime të mësuara kanë marrë trajnime për 6 Programe të shkurtuara. Ky pilotim i ofruar ka shërbyer si bazë fillestare që disa shkolla të shfrytëzojnë skemën e Junior Achievement i cili nuk është duke u financuar tani dhe i cili do të zëvendësohet me një program të ri të Arsimit në Ndërmarrësi.

4.1.3 Arsimi i mesëm i lartë. Pasqyrë e ngjashme – ekziston nevoja për të integruar arsimin për ndërmarrësi brenda lëndës së qytetarisë dhe programeve tjera. Skema e REA Prishtinës ishte duke vepruar edhe në sektorin e mesëm të lartë dhe duhet të zëvendësohet me programin e ri të arsimit në ndërmarrësi për arsye se financimi nuk është i mundur më.

4.1.4 Shkollat e AAP. Pasqyra është më e qartë këtu në Projektin e Financuar nga EU dhe Menaxhuar nga EAR/AER KOSVET I , pasi shkollat pilot të cilat , në përgjithësi kanë përdorur modulën e ndërmarrësisë të klasës 12 dhe në të shumtën e rasteve kanë përdorur modulën Aftësimi në Punë nga kurrikuli i njëjtë, ku nxënësit mund të kenë përvojë përmes firmat ushtrimore të shkollës. Firmat ushtrimore janë zhvilluar nga Swiss Contact dhe Eco Net të cilat janë duke punuar në disa shkolla Profesionale dhe Ekonomike. Ato kanë pasur sukses domethënës në informimin e industrisë dhe Ekonomisë lokale për aktivitetet e shkollës së AAP dhe kanë ndihmuar punësimin e të rinjëve, të cilët kanë përfunduar shkollën.

EBDL është Prezentuar dhe financuar nga Donatorët ,përgjithësisht nga Swiss Conatkt dhe GTZ. Futja në Përdorim e këtijë Kualifikimi të pranuar ndërkombëtarisht është bërë e mundur për të gjitha Shkollat , mirpo në fillim është garantuar se qasja do të

ketë shtrirje regjionale dhe në ato shkolla që i plotesojne Specifikacionin teknik si dhe te jetë e mundur qe individet dhe studentet te kenë qasje në sistem.

4.2 Arsimi i lartë

Universitetet dhe niveli para diplomimit, Deri më tani duket se është ofruar një pjesë shumë e vogël e arsimit dhe aftësimin në ndërmarrësi për studentët, edhe pse kurset që vijohen në fakultetet ekonomike dhe të biznesit kanë një sfond.

Programi TEMPUS në UP, që aktualisht është në fazën e parë të zhvillimit, ka identifikuar mënyrën me të cilën njësitë e inkubatorëve të biznesit për të diplomuarit dhe sapo diplomuarit mund të aranzhohen. Programi ka lidhje me Austrinë dhe Universitetet e Lobenit dhe Gotingenit. Programi TEMPUS ka plane për një fazë të dytë, i cili parashihet të fillojë në vitin 2007, dhe do të aftësojë 60 studentë (4 x 15) në Fillimin e Biznesit. Ata të gjithë do të prezantojnë një plan të biznesit dhe 5 – 10 më të mirët do të zgjidhen për njësinë e inkubatorëve, që do të vendoset në një lokacion. Kursi do të përbëhet nga 10 module, secili me kohëzgjatje 1 – 3 ditë kohëzgjatje dhe 5 ose 6 nga të cilat do të jenë kryesore.

4.3 Aftësimi i mësimdhënësve dhe trajnerëve

Ky është aktiviteti më kritik, sepse pa ofrimin e mësimdhënësve dhe trajnerëve të aftësuar për të zbatuar strategjinë, rezultati i fundit do të jetë më pak i kënaqshëm. Për momentin nuk ka aktivitet tjetër përveç udhëzimeve nga Rektorati për Fakultetin e Edukimit për të zhvilluar kurrikulin për arsim dhe aftësim në ndërmarrësi për mësimdhënësit Ekziston nevoja të zhvillohet një modul i shkurtër për ata që tash përfaqësojnë forcën mësimdhënëse dhe modul i veçantë për përfshirje në programin fillestar të aftësimin të mësimdhënësve. Zhvillimi duhet të marr parasysh qasjen në aftësimin për ndërmarrësi, që tashmë është paraqitur nga Swiss Contact dhe Eco Net.

Një numër i personelit të shkollës është aftësuar në zhvillimin e firmave ushtrimore nga EcoNET dhe Swisscontact, si dhe nga një numër i organizatave komerciale në shfrytëzimin e materialeve, të dobishme për këtë fushë të aktivitetit. Trajnimi i stafit për te Implementuar ECBL është financuar nga GTZ.

4.4 Arsimi joformal

MPMS ka 8 Qendra për Aftësim Profesional QAP, e cila ka organizuar trajnime për 3000 persona ne vitin 2005, nga numri total prej 320, 0000 punëkërkuesve te regjistruar prej 320.000, që do të thotë se është më pak se 1 %. Trajnimet janë ofruar në 25 profesione, ku 10% e tyre ka ndjekur modulën e vetëpunësimit. Problemi qëndron në

mospërkrahjen e atyre që ndjekin këtë rrugë, ndërsa bankat nuk dëshirojnë të përfshihen dhe nuk ekziston ndonjë sistem krediti. Është e nevojshme të paraqiten ndryshime në Qendrat e Aftësimit Profesional, pasi ky mësim përfshin aftësimin për profesione, për të cilat nuk ka më kërkesë, përderisa nuk ka qenë e mundur të ofrohen aftësim në profesionet që tashmë ka kërkesa në tregun e punës.

80 trajnerë janë në pozitat e tyre, por aktualisht shtyrja e afatit për punësimin e trajnerëve të rij, po ka efekt të dëmshëm në zhvillimin e fushave të reja të nevojshme.

MTI ka projektin për inkubatorët e biznesit. Ata janë duke ndërtuar tre inkubatorë të veçantë në Shtimje, Deçan dhe Gjilan, që do të kenë kapacitetin e fillimit të 20 bizneseve në secilën prej tyre. Këto pritet të jenë aktive rreth mesit të vitit 2007.

OJQ-te dhe Organizata Private që ofrojnë trajnime, por meqe nuk ka Organ Regullator që i licencon këto është e vështirë të dihet numri i ofruesve të trajnimeve dhe i klienteve të trajnuar.

4.5 Aftësimi për ofruesit e shërbimeve të biznesit

MTI ka 176 OSHB- Ofrues të Shërbimeve të Biznesit të akredituar. Akreditimi bëhet përmes aplikacionit, që mandej shqyrtohet nga paneli i selektimit, që noton aplikacionin sipas kualifikimeve dhe përvojës. Aplikimi mund të bëhet nga individët, OJQ-të dhe kompanitë private. Të fundit akreditohen të punojnë në fusha të veçanta, ndërsa individët kanë më tepër gjasë të punojnë në fusha ekonomike ose ligjore. Për këta trajnerë është ofruar aftësimi (32 ditë), në fushat e Menaxhimit të Projektit (9 ditë) Menaxhimit të Cilësisë (12 ditë) dhe E-mësimin (11 ditë).

4.6 Aftësimet për ndërmarrjet ekzistuese

MTI përmes skemës vauçer ofron aftësim dhe këshillime për ndërmarrjet ekzistuese. Aplikimi për këshillime bëhet te Zyra Rajonale e MTI, që gjithashtu do të ofrojë listën e trajnerëve të akredituar. Atëherë, ndërmarrja zgjedh OSHB ose individin e akredituar dhe e kthen në para të gatshme vauçerin me atë individ. Raporti i datës dhjetor 2006 dëshmon se janë bërë 349 kërkesa për vauçer dhe 136 janë dhuruar për totalin e ditëve prej 1776 ditëve.

Përveç prej shërbimit ekzistues për mbështetjen e menaxhimit të NVM nëpërmjet Skemës Vauçer të MTI, Oda Ekonomike dhe organizatave tjera, aktualisht ekzistojnë shërbime të ndryshme të programeve të aftësimit për menaxherët e NVM, që nevojitet të formalizohet së bashku me zhvillimin e certifikimit.

4.7 Arsimi në ndërmarrësi dhe perspektiva evropiane

Çdo shtet evropian ka një qasje kombëtare për zhvillimin e arsimit dhe aftësimin të ndërmarrësisë. Dokumentacioni në dispozicion për krahasim është i ndryshëm në qasje dhe ekzistojnë ndryshime të qarta në theks të përmbajtjes dhe në mënyrën në të cilën është planifikuar zbatimi. Mbase dokumentacioni më i dobishëm është i shteteve në vijim: Austri, Danimarkë, Norvegji, Francë etj., por koncepti mbetet i njëjtë – njohuri dhe vetëdijesim më i madh për biznesin është e dobishme për të gjithë ne si individë dhe si komunitet në tërësi. Për individët ofron një depërtim brenda botës së biznesit dhe lëvizje në zhvillimin e vetëpunësimit; për komunitetin zhvillon personat me të kuptuar më të madh të rolit dhe të kërkesave të atij roli si dhe u ofron shkathtësitë, që do të jenë në veçanti të rëndësishme në organizimet vullnetare dhe familje.

5. Sfidat

Pa dyshim sfida më e madhe për sukses të Strategjisë Kombëtare për Arsim dhe Aftësim në Ndërmarrësi janë resurset e kufizuara ekzistuese njerëzore dhe financiare, që janë të domosdoshme për zbatim. Nevoja për të rritur resurset e kufizuara është një sfidë kryesore, që do të kërkojë të gjithë aktorët të punojnë së bashku për arritjen e rezultateve më të mira të mundshme për Kosovë.

Me një qasje të tillë diverze për arsimin dhe aftësimin në ndërmarrësi, krijimi i koherencës shihet si një sfidë kryesore për zhvillim, ashtu që individët mund të gjejnë rrugën përpara.

Sfida më e madhe është të krijohën programe të trajnimit të Mësimdhënësve dhe Trajnimit të Trajnerve të cilat do të reflektonin në nevojat për të ofruar zhvillimin profesional të moduleve në trajnim pa shkeputje nga puna dhe aftësimin fillestar të mësimdhënësve, të cilët kanë përdorur materiale dhe trajnime të cilat janë implementuar me sukses. Modulet e reja duhet të jenë të përfunduara dhe të gatshme për tu ofruar për sesionin e parë të Trajnimit i cili është Programuar të fillojë gjatë verës 2007.

Sfida tjetër është që të caktohet kohe Planprogramit për Arsim në Ndërmarrësi në Shkollat fillore dhe të mesme të përgjithshme që të akomodohet si rezultat i ripunimit të Planprogrameve.

Ekziston nevoja për koordinim dhe lidhshmëri më të madhe në mes të organizatave të arsimit dhe aftësimin dhe industrisë e tregtisë lokale në mënyrë që të sigurohet një rritje domethënëse në mundësitë e praktikës në ndërmarrje dhe aftësim në punë.

Mund të ketë kërkesë që zhvillimi të përkrahët nga urdhëresat e përshtatshme administrative për të përligjur aktivitetin.

6. Qëllimet dhe plani i zbatimit

Objektivi kryesor është krijimi i një sistemi, që i ofron popullit të Kosovës shërbime të arsimit dhe aftësimin në ndërmarrësi, që mundëson përfundimin e njohurive dhe shkathtësive për të gjitha grupmoshat dhe ka efekt në stimulimin e zhvillimit të aktiviteteve të biznesit dhe kulturës së ndërmarrësisë. Kjo do të kërkojë zhvillimin e vetëdijesimit më të madh për përfitimet nga arsimit dhe aftësimi në ndërmarrësi, që duhet të promovohen nga përfituesit kryesor dhe ofrimi i mundësive, që të gjitha grupmoshat të përfitojnë prej mënyrave të ndryshme, përmes të cilave mund të fitohen njohuritë dhe shkathtësitë e tilla. Qëllimet kryesore të sektoreve janë përshkruar në vijim, dhe përshkrimi më i detajuar është bërë në planin Implementues.

6.1. Qëllimet për të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin Synimet për Arsimit dhe Trajnime për të gjitha Nivelet

Strategjia kombëtare për arsim dhe aftësim në ndërmarrësi dhe Standardet kombëtare për arsim dhe aftësim në ndërmarrësi do të përfundohen në mars 2007 (KOSVET) Zhvillimi i moduleve të reja për arsimin dhe aftësimin në ndërmarrësi dhe do të bëhet përfshirja e Arsimit dhe Aftësimin në Ndërmarrësi në të gjitha nivelet e Shkollimit.

6.2 Qëllimet për nivelet e arsimit fillor dhe të mesëm (Përgjegjësia MASHT)

Arsimi në Ndërmarrësi do të përfshihet në Planprogramet e Shkollave Fillore dhe të Mesme të Ulëta.

6.3 Qëllimet për arsimin e lartë (Përgjegjësia UP dhe MASHT)

Zhvillimi i moduleve për të paraqitur arsimin dhe aftësimin e ndërmarrësisë të studentët e të gjitha fakulteteve dhe në arsimin pas të mesëm.

Krijimi i aftësimin jashtë-kurrikular për përkrahjen e zhvillimit në industri dhe tregti, që janë të ndërlidhura për zhvillimin e biznesit.

6.4 Qëllimet për aftësimin e mësimdhënësve dhe trajnerëve

Zhvillimi i kursit për aftësimin në punë për mësimdhënësit, që të rrisin shkathtësitë e tyre në realizimin e aktiviteteve të arsimit dhe aftësimin në ndërmarrësi.

Zhvillimi i modulit të arsimit dhe aftësimin në ndërmarrësi të jetë pjesë e aftësimin fillestar të mësimdhënësve.

6.5 Qëllimet për mësimin joformal

Duhet që të zgjerohet shërbimet e Arsimit dhe Aftësimin në Ndërmarrësi përmes iniciativave të vogla lokale dhe qendrave mobile për aftësim,

Tre njësitë e inkubatorit të MTI do të jenë funksionale, dhe të kanë operimin e tyre ekonomik sa më parë të jetë e mundur.

Ndërmarrësia dhe/ose vetëpunësimi do të pranohen në të gjitha aktivitetet e AAP, përfshirë riaftësimin e të rriturve i cila duhet të ofrohet me standardet e AKK

Diskutime duhet të bëhen për të integruar dhe publikuar ofrimin e programeve të aftësimin për menaxherët e NVM në dhjetor 2007.

6.6 Plani i zbatimit

| Fusha | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | Financimi |
|--|--|------------------------------|------------|------------|--|
| Administrative | | | | | |
| Plani kombëtar i strategjisë të përfundohet me Përgjegjësia: KOSVET | 04.07. | | | | EAR/AER |
| Standardet kombëtare për AAN do të përfundohet me Përgjegjësia: KOSVET | 06.07 | | | | EAR/AER |
| Zhvillimi i moduleve ekzemplar për A&AN do të përfundohen deri më Përgjegjësia: KOSVET | 04.07 | | | | EAR/AER |
| Identifikimi i institucioneve për të zbatuar skemat e A&AN Përgjegjësia: Shkollat MASHT; aftësimet MPMS dhe MTI | 08.07 | | | | Nuk Nevojitet |
| Mbështetja ,monitorimi, vlerësimi dhe informata kthyesë e programeve Përgjegjësia: KOSVET | 02.07 | | | | EAR/AER |
| Pilot Programet do të Mbështetën ,monitorohën dhe evaluohën | Mbeshtetja do te vazhdoje filluar nga 03.07 | Mbeshtetja do te vazhdoje | | | EAR/AER |
| Aktivitetet ne lidhje me AA&N do te Promovohën Përgjegjësia MASHT,MPMS,dhe MTI e mbeshtetur nga KOSVET | shtator 07 | shtator 08 | shtator 09 | shtator 10 | Ministrite(2007-2008 Mbeshtetur nga EAR/AER) |
| Programet e AA&N do të ofrohen ne përputhje me Kërkësat dhe Standartet e KKSC Përgjegjësia MASHT,MPMS,dhe MTI | | Kah Fundi 2008 | | | Ministritë |

| Fusha | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | Financimi |
|---|--------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|---------------|
| Vazhdimësia Administrative | | | | | |
| Mbledhja e te dhënave dhe monitorimi në përputhje me Kartën Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme Përgjegjësia: MTI në bashkpunim me MPMS dhe MASHT | 07.2007 | 07.2008 | 07.2009 | 07.2010 | Ministritë |
| Aftësimi i Mësimdhënësve | | | | | |
| Moduli kombëtare për përfshirje në aftësimin fillestar të mësimdhënësve për AA&N do të zhvillohen më Përgjegjësia: Fakulteti i Edukimit | 06.07 | | | | MASHT |
| Moduli kombëtarë për aftësimin në punë Përgjegjësia: Fakulteti i Edukimit | 06.07 | | | | MASHT MPMS |
| Zhvillimi i stafit me kurset e AAN gjatë shërbimit, duhet të ofrohen për x mësimdhënës dhe trajnerë Përgjegjësia: MASHT, MPMS | 09.07 80 Mësimdhës 10 Trajnerë | 09.08 80 Mësimdhës 10 Trajnerë | 09.09 80 Mësimdhës 10 Trajnerë | 09.10 80 Mësimdhës 10 Trajnerë | MASHT MPMS |
| Zhvillimi i materialeve | | | | | |
| Zhvillimi i materialeve të pilot programeve që do ta mbështesin trajnimin e Mësimdhënësve për AA&N do të zhvillohet nga Përgjegjësia: KOSVET | | 10.08 | | | EAR/AER |
| Shkollat fillore dhe të Mesme të Ulta | | | | | |
| X numër i shkollave Fillore dhe të Mesme të ulta do të përfshijë disa aspekte të AAN në programet e tyre Përgjegjësia: MASHT | 10 | 20 | 30 | 40 | MASHT |
| Fusha | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | Financimi |

| | | | | | |
|---|------------------------|---------|------|------|--|
| Shkollat e Mesme te Larta (Gjimnazet dhe Shkollat Profesionale) | | | | | |
| EBDL i blerë dhe I Licensuar dhe Mësimdhënes të Trajnuar ne X Shkolla Përgjegjësia: MASHT | 52 | N,D | N.D | N.D | MASHT,GTZ |
| Programi i EBDL do të vazhdoje ne X shkolla Përgjegjësia: MASHT | N.D | N.D | N.D | N.D | MASHT (GTZ?) |
| Programi i Firmave Ushtrimore do të vazhdojë ne X shkolla Përgjegjësia:MASHT | 5 | 6 | 6 | 6 | MASHT, E Mbeshtetur nga Swisscontact dhe EcoNet |
| Programi i Firmave Ushtrimore do te filloje si shtese ne X shkolla Përgjegjësia: MASHT | N.D | N.D | N.D | N.D | MASHT, E Mbeshtetur nga Swisscontact dhe EcoNet |
| Moduli mbi Ndërmarrësinë (I Zhvilluar nga KOSVET 1) është Implementuar në X shkolla | 8 | 8 | 8 | 8 | MASHT |
| X numër i shkollave të mesme do të përfshijë Module të mësimet mbi AA&N në programet e tyre Përgjegjësia:MASHT | 19 | 29 | 39 | 50 | MASHT |
| Arsimi I lartë (Pas te Mësem) | | | | | |
| Qendra Për Biznese Fillestare do te vazhdoje te mbeshtese X numrin e studentve Përgjegjësia:Universiteti i Prishtines | 60 Deri me Qeshor 2007 | Vazhdon | ? | ? | EU Tempus |
| Zhvillimi i moduleve te reja ekzemplar për A&AN do të përfshihet dhe do te implementohët ne Arsimin pas të Mesëm Përgjegjësia: MASHT | 0 | 2 | 2 | 2 | MASHT |
| Fusha | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | Financimi |

| Arsimi i të Rriturve | | | | | |
|---|----|----|----|-----|--|
| Kurset e Ndërmarrësis dhe Vetë Punesimit do te vazhdojne ne X QAP Përgjegjësia :MPMS | 8 | 8 | 8 | 8 | MPMS |
| Zhvillimi i moduleve te reja ekzemplar për A&AN do te implementohet ne X QAP Përgjegjësia: MPMS | | 3 | 5 | 8 | MPMS |
| Zhvillimi i moduleve te reja ekzemplar për A&AN për profesionet e zejtarise ne viset rurale do te implementohët ne bashkpunim me X numri te OSHB (Ofrues të Shërbimeve te Biznesit) Përgjegjësia: MPMS,MTI | 2 | 5 | 10 | 15 | MPMS, MTI, Pjesmarresit dhe Donatoret |
| Zhvillimi i moduleve te reja ekzemplar për A&AN për Menaxherët e NVM do të implemetohet në bashkpunim me X numri te OSHB Përgjegjësia: MTI | 2 | 4 | 6 | 10 | MPMS, MTI, Pjesmarresit dhe Donatoret |
| Skema Vaucher per NVM do te vazhdoje per X perfitues (Ndermarres,Biznese Fillestare etj) Përgjegjësia: MTI | 40 | 60 | 80 | 100 | MTI,dhe Donatoret |

7. Masat dhe iniciativat

7.1 Masat dhe iniciativat që aplikohen në të gjitha nivelet e arsimit

Do të krijohet një grup koordinues i nivelit të lartë për arsimin dhe aftësimin në ndërmarrësi, do të themelohet me përfaqësues të MASHT, MPMS, MTI, Odën Ekonomike dhe bartësit e tjerë.

7.2 Masat dhe iniciativat në arsimin fillor dhe të mesëm

Në të dy sektorët, fillor dhe të mesëm, duhet një rishikim dhe kurrikulat e tanishme të mundësojnë kyqjen e Arsimit dhe Aftësimin në Ndërmarrësi

7.3 Masat dhe iniciativat në arsimin e lartë

Është imperative që MASHT sa më shpejtë t'i përgjigjet kërkesës së Fakultetit të Edukimit, që sa më shpejt të lejojë zhvillimin e kurrikulit për aftësimin e mësimdhënësve në punë për të paraqitur arsimin dhe aftësimin në ndërmarrësi në muajin qershor në 2007. Zhvillimi i një njësie për aftësim fillestar në A&AN duhet të jetë i gatshëm edhe për modulim e Aftësimin në punë të Mësimdhënësve dhe Trajnimit të Trajnerëve.

7.4 Masat dhe iniciativat në arsimin joformal

Përmes mënyrave fleksibile duhet të gjindet në lidhje me punësimin e personelit që të mund të tejkalohet moratoriumi i tanishëm i punësimit të trajnerëve në MPMS, që mund të përfshijë ri-aftësimin e trajnerëve tepricë.

8. Vlerësimi dhe Vazhdimësia

8.1 Vazhdimësia

Për të siguruar zbatimin e plotë të strategjitë, të gjithë akterët do të hartojnë një plan vjetor, që do të koordinohet nga MTI dhe dërgohet në zyrën e kryeministrit.

8.2 Financimi

Kalkulimet Financiare të planit të Implementimit nuk janë të kompletuara akoma Bugjeti vjetor i të tri Ministrive do të financoje punën sa të ketë mundësi

Ato gjatë tre vjetëve të mëparme kanë paraparë një fond të konsiderueshëm për arsim në Ndërmarrësi dhe nuk ka nevojë të studiohet se çfarë shpenzime - dobi do të paraqiten prej qasjes ndërkurrikulare.

Puna e ndërmarrë në bazë të kompetencave dhe aktiviteveve në Planprograme gjatë katër vjetëve të mëparme mund të transferohet edhe në Arsimin në Ndërmarrësi dhe të stimulohen fushat ato të cilat janë ndërmarrë në këtë drejtim.

8.3 Vlerësimi

Do të Ndërmirret nga një Grup i Pavarur i Emëruar dhe e cili do të Raportoje Zyrës së Kryeministrit.

Aneksi

Bashpunëtorët të cilët kanë marre pjese në zhvillimin e Strategjisë per Arsim dhe Aftësim në Ndërmarrësi:

Agjensioni i Përkrahjes së Punsimit Kosovë, APPK

Aleanca Kosovare e Biznesit, AKB

Bashkimi I Sindikatave të Pavarura të Kosovës, BSPK

EcoNet

Grate për Gratë

Oda Ekonomike e Kosoves, OEK

REA Prishtina

Shkolla Mileniumi i Tretë

Shoqata e Grave Afariste, SHE-ERA

Smarts Bits

Swiss Contact

Universiteti i Prishtines – Fakulteti Ekonomik

Zyra Gjermane per Bashkpunim Teknik, GTZ